



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 122

26 korrik

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 583, datë 17.7.2013	Për rritjen e pensioneve 5249
Vendim i KM nr. 591, datë 10.7.2013	Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013 5252

VENDIM
Nr. 583, datë 17.7.2013

PËR RITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen në masën 4 për qind të:

a) pensioneve të caktuara sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar me vendimin nr. 326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr. 758, datë 1.2.1994 të Presidentit të Republikës “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”;

d) shtesës mbi pension, të dhënë me nenin 33 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

dh) shtesave mbi pension, të dhëna me nenet 38, 39 dhe 48 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me nenin 24 të ligjit nr. 4171, datë 13.6.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

e) pensioneve të caktuara dhe të rilogaritura me ligjin nr. 10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

ë) trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara me ligjin nr. 8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, dhe trajtimit të veçantë financiar të pilotëve fluturues sipas ligjit nr. 9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”;

f) trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetësve dhe polumbarëve të forcave detare në pension”;

g) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të caktuara sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar;

gj) trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”;



h) pensioneve suplementare, të caktuara sipas ligjit nr. 10 139, datë 15.5.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë tituj shkencorë”.

2. Rritjen në masën 5 për qind të pensioneve të caktuara në përputhje me ligjin nr. 4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Rritjen, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, e përfshijnë edhe pensionet, të cilat caktohen nga data 1.8.2013 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit apo trajtimit të jetë deri më 30.7.2013, përfshirë edhe këtë datë.

4. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të këtij ligji, që kanë datë fillimi nga 1.8.2013 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 12 024 (dymbëdhjetë mijë e njëzet e katër) lekë në muaj dhe më shumë se 24 048 (njëzet e katër mijë e dyzet e tetë) lekë në muaj.

5. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.7.2013 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 8 233 (tetë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë në muaj, por jo më shumë 12 024 (dymbëdhjetë mijë e njëzet e katër) lekë në muaj.

6. Përfituesit e pensioneve dhe të ardhurave, të caktuara sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe me ligjin nr. 10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, me datë fillimi deri më 30.7.2013, përfshi edhe këtë datë, edhe pas rritjes së pensionit të caktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e çmimeve dhe kompensimin e të ardhurave mujore, sipas kriterëve dhe masës së përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave: nr. 138, datë 31.3.1994 “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, nr. 471, datë 15.7.1996 “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, nr. 401, datë 21.6.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr. 763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, nr. 415, datë 27.4.2009 “Për rritjen e pensioneve”, nr. 477, datë 30.6.2010 “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 17, datë 20.1.2007 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”.

7. Kompensimin e çmimeve, sipas kriterëve dhe masës së përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 31.3.1994 “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse” dhe nr. 471, datë 15.7.1996 “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, do ta marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione me datë fillimi nga 1.8.2013 e në vazhdim.

8. Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr. 763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, nr. 415, datë 27.4.2009 “Për rritjen e pensioneve”, nr. 477, datë 30.6.2010 “Për

rritjen e pensioneve”, dhe nr. 17, datë 20.1.2007 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”, do ta marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione me datë fillimi 1.8.2013 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave të jetë:

a) deri në 13 674 (trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë dhe pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi;

b) deri në 13 174 (trembëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë në muaj, për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare;

c) deri në 8 923 (tetë mijë e nëntëqind e njëzet e tre) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Pas datës 1.8.2013 të ardhurat minimale:

a) të personave, që përfitojnë pensionet e plota të pleqërisë dhe pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, përjashtuar ato të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe kompensime vetjake, nuk mund të jenë më të ulëta se 14 174 (katërbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë në muaj;

b) të personave që përfitojnë nga pensionet e caktuara sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe kompensime për çmimin e energjisë elektrike dhe për të ardhurat nuk mund të jenë më të ulëta se 9 123 (nëntë mijë e njëqind e njëzet e tre) lekë në muaj dhe më të larta se 12 224 (dymbëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e katër) lekë në muaj.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 1 411 (një mijë e katërqind e njëmbëdhjetë) milionë lekë, të përballohen nga fondet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Kontingjencës, të parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2013 dhe ndahen:

a) për mbulimin e pagesave të pensioneve, në shumën 1 395 (një mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) milionë lekë;

b) për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a. në shumën 16 (gjashtëmbëdhjetë) milionë lekë.

11. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për të nxjerrë udhëzimet teknike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.8.2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 591, datë 10.7.2013

PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË SHPENZIMEVE BUXHETORE, PËR VITIN 2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16 e 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Duke nisur nga data 15 korrik 2013, botimi i çdo lloj njoftimi për prokurim të fondeve buxhetore për shpenzime kapitale dhe korente të njërive të qeverisjes së përgjithshme, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, bëhet vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përfshihen nga ky rregull:

- njoftimi i kontratës së nënshkruar për procedura të shpallura para datës 15 korrik;
- njoftimi i kontratës së nënshkruar për procedura për negocim pa publikim, kur këto kontrata janë lidhur deri në datën 15 korrik dhe janë dërguar për publikim brenda afatit ligjor;
- fondet buxhetore që shkojnë për shërbimin e ushqimit apo medikamenteve në ato njësi të qeverisjes së përgjithshme, në të cilat kryhet ky shërbim;
- prokurimet për blerjet e vogla;
- investimet nga të ardhurat e realizuara nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme;
- njoftimet lidhur me procedurat për projektet e financuara në të gjitha programet nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

2. Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes (602 dhe 605) të njërive të qeverisjes qendrore, të pakontraktuara deri në datën 15 korrik, pasi të zbriten fondet për pagesën e energjisë elektrike, ujit dhe telefonisë, ngurtësohen në masën 20 për qind të pjesës së mbetur.

3. Reduktohet 30 për qind masa e mbulimit të shërbimit të telefonisë celulare për çdo përfitues nga vendimi nr. 864, datë 23.7.2010 i Këshillit të Ministrave “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”.

4. Fondet e papërdorura për pagesën e telefonisë fikse, për periudhën e mbetur, reduktohen në masën 50 për qind në të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nëpërmjet përgjysmimit të limiteve mujore për çdo përdorues.

5. Fondi i veçantë i planifikuar në njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk përdoret deri më 2 dhjetor 2013, përveç rasteve për ndihma të menjëhershme dhe të shpërblimit për daljet në pension pleqërie, në masën e përcaktuar në pikën 7 të vendimit nr. 929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar, pavarësisht nga masa e përcaktuar në akte të tjera ligjore e nënligjore.

6. Shpenzimet për udhëtim e dieta jashtë vendit për njësitë e qeverisjes së përgjithshme reduktohen duke lejuar financimin me fonde buxhetore vetëm të udhëtimeve të rëndësishme së veçantë, për aktivitete që përfshijnë titullarët e institucioneve qendrore, ku pjesëmarrës mund të jenë ata vetë apo të deleguarit e tyre. (Institucione qendrore në kuptim të këtij kufizimi janë ministritë, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave dhe institucionet e pavarura.) Në rastin e pjesëmarrjes në konferenca apo aktivitete, për të cilat paguhet tarifë pjesëmarrjeje, merret paraprakisht miratimi i Ministrit të Financave.

7. Trajnimet/seminaret/kurset jashtë vendit për nëpunësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të parashikuara për t'u mbuluar plotësisht apo pjesërisht me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2013, bllokohen.

8. Fondet buxhetore të papërdorura deri në miratimin e këtij vendimi për trajnimet/seminaret/kurset brenda vendit për nëpunësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të parashikuara për t'u mbuluar plotësisht apo pjesërisht me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2013, reduktohen në masën 50%.

9. Ngarkohen të gjitha institucionet e njësive të qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 26.7.2013
Doli nga shtypi më 26.7.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 10 lekë